



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KRYETARI

Nr. 4708/prot.  
5

Pogradec, më 15, 11, 2024

**Lënda:** Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

**Z. MANJOLA KAMOLLI**

**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK**

**E nderuar zonja Kryetare,**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

**“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PËR NDERTIM PARK FOTOVOLTAIK (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PERKATESE), NË PASURITE ME SIPËRFAQE TOTALE 47.4663 (DYZET E SHTATE PRESJE KATERMIJE E GJASHTEQIND E GJASHTEDHJETE E TRE) HA”.**

Me respekt,

**KRYETARI**  
**Ilir XHAKOLLI**



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 12 (Dymbëdhjete)



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
BASHKIA POGRADEC  
KESHILLI

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Pogradec, më \_\_\_\_\_ 2024

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/2024

**PËR**

**MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PËR NDERTIM PARK FOTOVOLTAIK (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PERKATESE), NË PASURITE ME SIPËRFAQE TOTALE 47.4663 (DYZET E SHTATE PRESJE KATERMIJE E GJASHTEQIND E GJASHTEDHJETE E TRE) HA.**


Në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave /Bashkive", të ndryshuar me vendimin nr 398 date 13.05.2020, Udhezimit Nr.13, datë 26.04.2018 "Per zbatimin e vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë në parim dhënien në përdorim, për ndërtim park fotovoltaiik (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese), në pasuritë e ndodhura në fshatin Homezh Njësinë Administrative Proptisht, fshatin Udenisht Njësinë Administrative Udenisht Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Nr Pasur	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kerkeses
1	1959	486	Homezh, Proptisht	230788	Park Fotovoltaiik
2	3665	811	Udenisht, Udenisht	243875	Park Fotovoltaiik
			SHUMA	474663	

2. Afati i dhënies me qera të jetë deri në 10 vite, me të drejtë ripertëritje, sipas periudhes të percaktuar në projekt, dhe studimin e fizibilitetit të dorëzuar nga kërkuesit në konkurim.

- 
2. Ky proces te kryhet sipas percaktimeve të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 te Keshillit te Ministrave "Për percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar.
  3. Tarifat për dhënie në përdorim/qera të këtyre pasurive, të aplikohen sipas pika 8 e shtojces nr 1 te Vendimit të Keshillit te Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".
  4. Shoqëritë kërkuese të përdorin pasuritë e mësipërme për ushtrimin e aktivitetit të saj sipas objketit të parashikuar ne kërkesën e tyre dhe studimin e fizibilitetit te paraqitur per marrjen në përdorim të pasurive.
  5. Të Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec për lidhjen e kontratës, mbas përfundimit të procedurave konkurruese.
  6. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.
  7. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

**KRYETAR  
MANJOLA KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KESHILLI

Nr. ~~478~~ prot.  
5

Pogradec, më 15/11/2024

RELACION

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PËR NDERTIM PARK FOTOVOLTAIK (STACIONET, BAZAMENTET DHE OBJEKTET PERKATESE), NË PASURITE ME SIPËRFAQE TOTALE 47.4663 (DYZET E SHTATE PRESJE KATERMIJE E GJASHTEQIND E GJASHTEDHJETE E TRË) HA.**

**I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !**  
**TË NDERUAR KËSHILLTARË !**

Bashkia Pogradec në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, referuar pikës 2 të nenit 27 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ndër të cilat është edhe Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme pyje etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, posacerisht të kaluara në pronësi të saj me Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish-komunave /Bashkive", te ndryshuar me vendimin nr. 398 date 13.05.2020. Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin. Për sa më sipër, Sektori i verifikimit të titujve të pronësise, Bashkia Pogradec, ka marrë në shqyrtim mundesine dhe pronat që mund të përdoren për ndertimin dhe zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe prodhimit të saj nga dielli, sektori perkates evidentoi pasurite që ndodhen në pjesë të dukshme dhe që janë shumë të mira për zhvillimin e këtij procesi në fushën e energjisë së rinovueshme.

Gjate shqyrtimit edhe verifikimi i statusit të pronësise, të pasurive objekt këtij projektvendimi dhe rezultoi si me poshtë:

- 1.- Pasuria 486 në zonen kadastrale 1959 Fshati Homezh me sipërfaqe 230788 m2 shtrihet në një tokë pyjore kullote të abandonuar dhe demtuar si nga erozioni dhe faktore të tjera atmosferike, kjo sipërfaqe nuk është e punuar dhe përdorur që nga vitet 90 afër 30 vjet, nuk posedohet apo zotërohet nga asnjë individ në fshat apo tjetër kund, kete e vertetoj edhe keqyrja në vend të saj dhe certifikata e pronësise në emer të Bashkise Pogradec.
- 2.- Pasuria 811 në zonen kadastrale 3665 Fshati Udenisht me sipërfaqe 243875 m2 shtrihet në një tokë pyjore kullote të abandonuar dhe demtuar si nga erozioni dhe faktore të tjera atmosferike, kjo sipërfaqe nuk është e punuar dhe përdorur që nga vitet 90 afër 30 vjet, nuk posedohet apo zotërohet nga asnjë individ në fshat apo tjetër kund, kete e vertetoj edhe keqyrja në vend të saj dhe certifikata e pronësise në emer të Bashkise Pogradec.

Per sa me sipër, si dhe para se të dorëzohet projekt vendimi në Keshill, u mbajt korespondenca me ASHK Drejtoria Vendore Pogradec dhe jemi paisur me certifikatën e pronësise për këto pasuri, Në keto kushte, në mbështetje të; pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, dhe gërmas "e" të nenit 54 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 24/2023 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", Ligjit Nr.

44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe kullotave publike sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrise se Mjedisit e te ish-komunave /Bashkive", te ndryshuar me vendimin nr 398 date 13.05.2020, Udhezimit Nr.13, datë 26.04.2018 "Per zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar, i propozojme Keshillit Bashkiak të miratojë në parim dhënien në përdorim, me konkurim në favor të shoqërive kërkuese, me kontratë qeraje me afat deri ne 10 vite, me te drejte ripertëritje sipas periudhes te percaktuar ne projekt dhe studimit të fizibilitetit qe do dorezohen nga kerkuesit, per ngritje parku fotovoltaiq, me klauzole ne kontrate qe neqoftese nuk realizohet ndertimi i parqeve sipas lejes se Ministrise perkatese, vitin tjetër mbas mbarimit te lejes prona kalon ne administrim te Bashkise Pogradec dhe kontrata qubet e prishur. Miratimin e dhenies me qira për pasurinë e ndodhura në fshatin Homezh Njësinë Administrative Proptisht, fshatin Udenisht Njësinë Administrative Udenisht Bashkia Pogradec, me të dhënat si më poshtë:

Nr	Z.K	Nr Pasur	Vëndodhja	Siperf në m2	Objekti kerkeses
1	1959	486	Homezh, Proptisht	230788	Park Fotovoltaiq
2	3665	811	Udënisht, Udënisht	243875	Park Fotovoltaiq
			SHUMA	474663	

Ne referim te bazes ligjore te sipercituar, ky proces te kryhet sipas percaktimeve të Vendimit Nr. 54, datë 05.02.2014 te Keshillit të Ministrave "Për percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar.

Tarifat për dhënien në përdorim/qera të ketyre pasurive, të aplikohen sipas pika 8 e shtojces nr 1 te Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 559, datë 29.7.2022 "Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

Gjithashtu, kontrata bashkengjitur projekt vendimit, eshte hartuar ne zbatim te Vendimit Nr. 421, datë 12.6.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për percaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

Keshilli Bashkiak kaloi në konsultim publik kete kerkese dhe ne datat 26/10/2024 dhe 28/10/2024 u mbajten takimet ne Fshatin Homezh Njesia Administrative Proptisht Pogradec si dhe ne fshatin Udensiht Njesia Administrative Udenisht, pavaresisht ketyre takimeve dhe opinionëve te banorëve te cilat I moren edhe perfaqesuesit e keshillit qe ishin ne keto takime në zbatim të nenit 54, shkronja "e" të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2014 "Për veteqeverisjen vendore", citohet se: "**Këshilli bashkiak, ndër të tjera, e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve**".

**Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:**

**Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:**

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, "Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj."

Po kështu, në ligjin 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: "Akte me karakter normativ" janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore".

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja "a" përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", neni 3, pika 2 përcakton si vijon: **"Akt normativ nënligjor"** është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij".

Neni 3 pika 1 shkronja "a" e Kodit të Procedures Administrative jep këtë perkufizim për 1. "Akti administrativ":

a) **"Akti administrativ individual"** është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) **"Akti administrativ kolektiv"** është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një projekt-vendim i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative", pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili nuk është i shteruar në zbatimin e tij dhe që me miratimin e tij do të sjellë pasoja juridike për pronat që mund të perdoren për ndërtimin dhe zhvillimin e energjisë së rinovueshme dhe prodhimit të saj nga dielli, për pasuritë që ndodhen në pjesë të dukshme dhe që janë shumë të mira për zhvillimin e këtij procesi në fushën

e energjisë së rinovueshme që shtrihen ne territorin e Bashkisë Pogradec, kundrejt një numri të pacaktuar subjektesh.

Përfundimisht konkludojmë se akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Duke pasur besim te plote, ju ftojme te miratoni projekt vendimin e paraqitur.



Të dhënat e projekt vendimit:

Konceptoi: Nexhmi TORRA

Jurist i Drejtorisë Juridike: Katerina TANE

Miratoi: Johan STERJO

Konfirmoi: Dritan BABASULI

**KRYETAR  
ILIR XHAKOLLI**

Pexhu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI



Nr. 101/ Prot.

Date 14.11.2024

Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë z. Ilir Xhakolli

Lenda : Dërgohen rekomandimet e dhëna nga komuniteti gjatë procesit të konsultimit publik të projekt-aktit: "Miratimin në parim të dhënies në përdorim ,për ndërtim aerogjeneratore, fotovoltaike, (stacionet, bazametet dhe objektet përkatëse) në pasurinë me sipërfaqe totale 47,4663 (dyzet e shtatë presje katër mijë e gjatëqind e gjashtëdhjet e tre) ha".

I nderuar Z. Kryetar !

Në zbatim të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Neni 54, si dhe të Vendimit nr.2 datë 07.07.2023 të Kryesisë së Këshillit të Bashkisë, Komisioni i ekonomisë realizoi procesin e konsultimit publik me banorët e fshatit Udënisht dhe Homezh në përputhje me Regulloren për Konsultimin Publik, në lidhje me Projekt-Vendimin: "Miratimin në parim të dhënies në përdorim ,për ndërtim aerogjeneratore, fotovoltaike, (stacionet, bazametet dhe objektet përkatëse) në pasurinë me sipërfaqe totale 47,4663 (dyzet e shtatë presjekatër mijë e gjatëqind e gjashtëdhjet e tre) ha".

Bashkangjitur po ju dërgojmë mendimet dhe sygjerimet e banorve të shprehura gjatë realizimit të konsultimeve punlike në të dy fshatrat në lidhje me këtë projekt-vendim.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin!

Me respekt

Sekretare e Këshillit

Jona BOJKO





## Procesverbal



### Konsultim publik :

**Data :** 28/10/2024 **Ora :** 14 / :10

**Vendi:** Salla e mbledhjeve njesia administrative Udenisht

**Numri i pjesëmarrësve :** Gjithësej 29 persona të pranishëm (25 burra), (4 gra).

### Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

Për miratimin në parim të dhënies në përdorim për ndërtim park fotovoltaiq (stacionet,bazamentet dhe objektet perkatëse),në pasuritë me sipërfaqe truall 47.4663(dyzet e shtatë presje katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e tre) ha."

### Pjesëmarrës :

Klea Topa (Kryetare komisioni)

Vjollca Plaha (Këshilltare)

Engjëll Shyti(Këshilltar)

Nexhmi Torra(Specialist)

Matilda Tollaku (Punonjse sekretariati)

**Klea Topa(Kryetare komisioni)bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar dhe reacionin shoqërues.
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.
- Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.
- Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve.

**Klea Topa(Kryetare komisioni)**

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

**Klea Topa (Kryetare komisioni)**

Ju falenderoj për pjesëmarrjen e sotme në këtë konsultim publik. Në mbledhjen e këshillit Bashkiak dt. 29.08.2024 jemi njohur me projekt-vendimin në fjalë dhe sipas të gjitha rregullave dhe ligjit në fuqi u kalua për konsultim publik. Procesi i konsultimit ka një sërë procedurash të cilat jemi duke i ndjekur hap pas hapi. Sot po zhvillojmë takimin me banorët, me disa këshilltarë dhe me përfaqësues të sekretariatit të Këshillit Bashkiak. Sot jemi këtu për të dëgjuar mendimin tuaj!

**Nexhmi Torra (Specialist):** Ju falenderoj për pjesëmarrjen e sotme në këtë konsultim publik. Ne kemi biseduar në lidhje me këtë çështje, megjithatë gjërat e paqarta mund t'i diskutojmë së bashku. Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 20.08.2024 kemi paraqitur projekt-vendimi me titull : Për miratimin në parim të dhëniës në përdorim për ndërtim park fotovoltaik (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatëse), në pasuritë me sipërfaqe truall 47.4663 (dyzet e shtatë presje katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e tre) ha. "Disa projekt-vendime kanë nevojë edhe për miratimin tuaj , ndaj vendos që të kalohej në konsultim publik.

Gjatë shqyrtimit dhe verifikimit të statusit të pronësisë ,kjo pronë ka qënë plan e ish-komunës Proptisht, por sipas ndarjes së re kadastrale e ka marrë Njësia administrative Udënisht!

Para se të dorëzohet projekt-vendimi në Këshill, u mbajt korespondenca me ASHK-N Drejtoria Vendore Pogradec dhe jemi pajisur me certifikatën e pronësisë për këtë pasuri.

Është detyrimi ynë ligjor që të kemi edhe miratimin tuaj.

**Klodi Selko (Administrator i Njesis Udënisht):**

Ku ndodhet kjo pronë?

**Nexhmi Torra (Specialist):** Kjo ndodhet në krahun e Qafë Thanës. Në atë pjesë ku është kjo tokë nuk i prish punë askujt dhe për ne .Ideja e konsultimit është që dhe ju të kërkonit dicka nga kompania private që tju hyjë në punë.

**Klodi Selko (Administrator i Njesis Udënisht):**

Në këto pjesë toke i vetmi aktivitet që kryhet është mbarështimi i bagëtive, por kjo nuk i pengon blektorët.

**Banori 1.**

Ne duam që të behet rruga e fshatit, të shtrohet me asfalt të ri.

**Banori 2.**

Përsa i përket antenave ne nuk na prish punë. Firma të mirëmbajë rrugën.

**Klodi Selko (Administrator i Njesis Udënisht):**

Duhet të keni parasysh që të mos preket liqeni dhe tokat buzë tij.

**Nexhmi Torra (Specialist):** Nëse nuk keni dicka tjeter për të shtuar ju falenderoj për prezencën.

Sekretare e Këshillit  
Jona BOJKO





## Procesverbal

### Konsultim publik :

Data : 26/10/2024 Ora : 12 / :10

Vendi: Salla e mbledhjeve njesia administrative Homezh

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 14 persona të pranishëm (11 burra), (3 gra).

### Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

Për miratimin në parim të dhëniës në përdorim për ndërtim park fotovoltaiik (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese), në pasuritë me sipërfaqe truall 47.4663 (dyzet e shtatë presje katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e tre) ha."

### Pjesëmarrës :

Besnik Xhyra (Kryetar komisioni)

Nexhmi Torra (Specialist)

Ramis Pura (Administrator i Njesis Proptisht)

**Besnik Xhyra (Kryetar komisioni) bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :**

- Projekt-aktin e propozuar dhe reacionin shoqërues.
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.
- Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.
- Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- Tregoi kalendarin e konsultimit publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve.

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan, dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :**

**Besnik Xhyra Kryetar (komisioni)**

Ju falenderoj për pjesëmarrjen e sotme në këtë konsultim publik. Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak dt. 29.08.2024 jemi njohur me projekt-vendimin në fjalë dhe sipas të gjitha rregullave dhe ligjit në fuqi u kalua për konsultim publik. Procesi i konsultimit ka një sërë procedurash të cilat jemi duke i ndjekur hap pas hapi.

Sot po zhvillojmë takimin me banorët dhe me disa këshilltarë. Sot jemi këtu për të dëgjuar mendimin tuaj.

**Nexhmi Torra (Specialist):** Ju falenderoj për pjesëmarrjen e sotme në këtë konsultim publik. Ne kemi biseduar në lidhje me këtë çështje, megjithatë gjërat e paqarta mund t'i diskutojmë së bashku.

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 20.08.2024 kemi paraqitur projekt-vendimi me titull : Për miratimin në parim të dhëniës në përdorim për ndërtim park fotovoltai (stacionet, bazamentet dhe objektet perkatese), në pasurit me sipërfaqe truell 47.4663 (dyzet e shtatë presje katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e tre) ha. "Disa projekt-vendime kanë nevojë edhe për miratimin tuaj , ndaj vendos që të kalohej në konsultim publik.

Gjatë shqyrtimit dhe verifikimit të statusit të pronësis, kjo pronë ka qënë plan e ish-komunës Proptisht Para se të dorzohet projekt-vendimi në Këshill, u mbajt korespondenca me ASHK-n Drejtoria Vendore Pogradec dhe jemi pajisur me certifikatën e pronësisë për këtë pasuri.

Është detyrimi ynë ligjor që të kemi edhe miratimin tuaj.

**Ramis Pura (Administrator i Njësis Proptisht):**

Ku ndodhet kjo pronë?

**Nexhmi Torra (Specialist):** Kjo ndodhet në majë të kodrës. Në atë pjesë ku është kjo tokë nuk i prish pun askujt dhe për ne .Ideja e konsultimit është që dhe ju të kërkonit dicka nga privati që tju hyjë në punë.

**Ramis Pura (Administrator i Njësis Proptisht):** Në këto pjesë tokë i vetmi aktivitet që kryhet është mbarështimi i bagëtive, dhe asnjë nga banorët nuk është dakort.

**Banori 1.**

Ne duam që te kjo pjesë të mos preket sepse ne e përdorim për të kullotur blektorinë. Në fshat janë disa tufa .

**Banori 2.**

Ne nuk jemi dakort sepse kjo tokë përdoret për kullotë.

**Ramis Pura (Administrator i Njësis Proptisht):** Banor nuk janë dakort dhe do të nënshkruajnë një deklaratë ku pohojnë që nuk janë dakort që kjo tokë të mos jepet me qera.

**Nexhmi Torra (Specialist):** Nëse nuk keni dicka tjetër për të shtuar ju falenderoj për prezencën.

Sekretare e Këshillit

Jóna BOJKO





## **Përmbledhje e rekomandimeve të konsultimit publik**

### **Titulli i Projekt-aktit :**

-"Miratimin në parim të dhënies në përdorim ,për ndërtim aerogjeneratore, fotovoltaike, (stacionet, bazametet dhe objektet përkatëse) në pasurinë me sipërfaqe totale 47,4663 (dyzet e shtatë presjekatër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e tre) ha.

Grupet që u konsultuan: Banorët e fshatit Udenisht

**Numri total i pjesëmarrësve në konsultime : 29 Persona**

**Numri i personave që dhanë rekomandime: 3 Rekomandime**

**Rekomandimet e dhëna në takimin publik ose të dërguara me postë në lidhje me çështjen që konsultohet janë :**

Nr Rekomandimi	Nr i rekomanduesve	Nga procesverballi i takimeve	Dërguar me postë
1 Të përdoret për projektin vetëm ngastëra që është përcaktuar në projekt-vendim, pra vetëm kodra, sepse pjesa tjetër përdoret përmbarshtimin e bagëttive.	1 Rekomandim	Nga Procesverballi i Takimit në fshatin Udënisht	Po
2 Duhet të kini parasysh që të mos preken tokat buze liqenit.	1Rekomandim	Nga Procesverballi i takimit në fshatin Udënisht	Po
3 Të shtohet një pikë shtesë në kontratën që do të firmoset nga firma për rregullimin e rrugës së fshatit.	1 Rekomandim	Nga Procesverballi i takimit në fshatin Udënisht	Po



Sekretari I Këshillit

Jona Bolko





## **Përmbledhje e rekomandimeve të konsultimit publik**

### **Titulli i Projekt-aktit :**

-"Miratimin në parim të dhënies në përdorim ,për ndërtim aerogjeneratore,fotovoltaike,(stacionet,hazametet dhe objektet përkatëse)në pasurinë me sipërfaqe totale 47,4663 (dyzet e shtatë presjekatër mijë e gjashtëdhjet e tre)ha.

Grupet që u konsultuan:Banorët e fshatit Hornmezih

**Numri total i pjesëmarrësve në konsultime : 14 Persona**

**Numri i personave që dhanë rekomandime: 3 Rekomandime**

Rekomandimet e dhëna në takimin publik ose të dërguara me postë në lidhje me gëshhtjen që konsultohet janë :





Nr. Rekomandimi	Nr i rekomanduesve	Nga procesverball i takimeve	Dërguar me postë
1 <b>Banori 1.</b> Ne duam që të kjo pjesë të mos preket sepse ne e përdorim për të kultotur btektorinë. Në fshat janë disa tufa.	1 Rekomandim	Nga Procesverball i Takimit në fshatin Homezh	Po
2 Ranis Pura (Administrator i Njesis Propitshk): Në këto pjesë toke i vetmi aktivitet që kryet është mbarshtimi i bagëtive, dhe asnjë nga fshatarët nuk është dakort.	1Rekomandim	Nga Procesverball i takimit në fshatin Homezh	Po
3 <b>Ranis Pura (Administrator i Njesis Propitshk):</b> Fshatarët nuk janë dakort dhe do të nënshkruajnë një deklaratë	1 Rekomandim	Nga Procesverball i takimit në fshatin Homezh	Po



ku pohojnë që nuk janë dakortë që kjo tokë të  
mos jepet me qera.

--	--	--	--

**Sekretari i Këshillit**

**Jona Bojko**



Consultim Publike me honorat  
= fshatit Honorat per dhemur e tokes me  
qora



Te gjitha honorat e fshatim me 1000000 lekesh  
qe kjo tokes te jepet me para, pasi eshte  
tallote dhe iu duhet per klagfaren, pasi  
me fshat te shume tufa me kopeli te simta  
Emrat e komerere te cilet me jane dakort:

- 1) Hajri Durrani
- 2) Mehmet Gjata
- 3) Gazim Durrani
- 4) Fehri Durrani - me dakort
- 5) Muzie Durrani
- 6) Berish Muntshiu
- 7) Shkurt Durrani - me dakort
- 8) Zyrt Durrani 1000000
- 9) Nazim Durrani
- 10) Mustafa Durrani
- 11) Flamur Durrani
- 12) Merishe Durrani
- 13) ...
- 14) ...
- 15) ...

*[Handwritten signature]*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



# ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

## PRONARI/BASHKËPRONARËT

Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA POGRADEC	K44802605R	1/1

Numri i Pasurisë	486		
Kodi Unik	1959007125		
Zona Kadastrale	1959		
Lloji i Pasurisë	KULLOTE		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 230788	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë	POGRADEC, POGRADEC, Rr.: HOMEZH		

DREJTORI  
Zhuljen Manellari

Franci  
Beshiraj

Digitally signed by  
Franci Beshiraj  
Date: 2024.08.30  
09:14:06 +0200

Eugen  
Alinj

Digitally signed by  
Eugen Alinj  
Date: 2024.08.30  
09:19:34 +0200

Data e lëshimit 30/08/2024  
Manellari

Digitally signed by  
Manellari  
Date: 2024.08.31  
12:48:31 +0200



Vullnet elektronik nga Drejtoria  
Vendore Pogradec  
Date: 2024.08.31 14:13:50 +0200  
K44802605R2024083014135305L1014



Zhënie: Ky dokument është gjeneruar dhe vlerësuar në mënyrë  
elektronike nga sistemi elektronik i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 1959007125  
(Nga \_\_\_\_, Në \_\_\_\_)

**A - TË DHËNAT E PASURISË**

Zona Kadastrale Nr. 1959 , Lloji i Pasurisë: KULLOTE , Nr. i Pasurisë: 486 , Sipërfaqja Totale 230788 m2, (Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale K - 34 - 114 - ( 20-A ) , Numri i Pemëve: 0 ,  
Adresa e Pasurisë: Bashkia POGRADEC , Rruga HOMEZH , Ndërtesa Nr. \_\_\_\_, SH/K 255 ,  
Apartamenti Nr. \_\_\_\_,  
Vlera e Pasurisë:  
Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 2481 , Dt. 22/08/2024), Rivlerësim \_\_ (Akti Nr. \_\_, Dt. \_\_\_\_)

**B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË**

Pronari: BASHKIA POGRADEC , Nr. Identifikimi/NIPT K44802605R , Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I  
Adresa e Pronarit: Bashkia \_\_, Rruga DESHMORET E POJSKES , Ndërtesa Nr. \_\_\_\_, SH/K \_\_\_\_,  
Apartamenti Nr. \_\_\_\_

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo vendimet e shpronësimit), Nr. 2481 , Datë: 22/08/2024  
Regjistruar: Nr. 2481 , Datë: 30/08/2024

*\*Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. \_\_\_\_, me Kod Unik \_\_\_\_*

**B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK**

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: \_\_\_\_, Nr. \_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_  
Përshkrimi i Objektit të Aktit: \_\_\_\_  
Regjistruar: Nr. \_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHQIPTËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PATUAJTSHMË

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrim	Dt. Regjistrim	Lloji i Shërbimit	L. Deregullimi			Mënyra Vlerësimore	Pasiguria	
			Nr. i Aktit	Datë	Drejtues		Nr. Identifikues Nj.	

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrim	Dt. Regjistrim	Lloji i Kufizimit	L. Deregullimi			Mënyra Kufizimit	Përfituesi i Kufizimit	
			Nr. i Aktit	Datë	Drejtues		Nr. Identifikues Nj.	

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: \_\_\_\_\_, Emërtimi i Aktit: \_\_\_\_\_, Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_\_\_\_

Regjistruar: Nr. \_\_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_\_

Përshkrimi: KO'7 0 0120 KULLOTË, PJESA TJETËR E SIPERFAQES NDODHET NE PASURINE ME NR.811, DIFERENCË DOK FAKT, 17, REF 2481 edhe ne udenish!

DREJTORI  
Zhujten Manellari

Franci Eshraj  
Eshraj Eugjen Alinj

Udhëzues i Zhujten Manellari  
Data e lëshimit 30/08/2024



Agjencia Shqiptare e Kadastres  
Vendbanim dhe Transport  
Emri: 3024/0133-0-02-02/20  
K4400760801071031071472010-00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 1959

KODI UNIK: 1959007125

NUMRI PASURISË: 486

INDEKSI HARTËS: K - 34 - 114 - (

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI

Zhuljen Manellari

Eugen

Alirj

Digitally signed by  
Eugen Alirj  
Date: 2024.08.30  
17:16:00

Zhuljen

Manellari

Digitally signed by  
Zhuljen Manellari  
Date: 2024.08.31  
12:45:43 +0200



Valtor elektronikisht nga Drejtoria  
Vendosa Pogozic  
Data: 2024/08/30 17:16:08 +0200  
K14832605R20240530171628074014

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDËRTESA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 3665014023  
(Nga \_\_\_\_, Në \_\_\_\_)

**A - TË DHËNAT E PASURISË**

Zona Kadastrale Nr. 3665, Lloji i Pasurisë: KULLOTE, Nr. i Pasurisë: 811, Sipërfaqja Totale 243875m<sup>2</sup>,  
(Nga të Cilat Truall 0 m<sup>2</sup>; Ndërtesë 0 m<sup>2</sup>)

Indeksi i Hartës Kadastrale K - 34 - 114 - (20-A), Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia \_\_\_\_, Rruga \_\_\_\_, Ndërtesa Nr. \_\_, SH/K 255, Apartamenti Nr. \_\_

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 2481, Dt. 22/08/2024), Rivlerësim \_\_ (Akti Nr. \_\_, Dt. \_\_\_\_)

**B - TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË**

Pronari: BASHKIA POGRADEC, Nr. Identifikimi/NIPT K44802605R, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia \_\_, Rruga DESHMORET E POJSKES, Ndërtesa Nr. \_\_, SH/K \_\_, Apartamenti Nr. \_\_

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Vendim i KM (për kalim në pronësi të institucionit shtetëror/apo vendimet e shpronësimit), Nr. 2481, Datë: 22/08/2024

Regjistruar: Nr. 2481, Datë: 30/08/2024

*\*Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. \_\_\_\_, me Kod Unik \_\_\_\_*

**B/1 - TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK**

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: \_\_\_\_, Nr. \_\_, Datë: \_\_\_\_

Përshkrimi i Objektit të Aktit: \_\_\_\_

Regjistruar: Nr. \_\_, Datë: \_\_\_\_





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Drejtës	Të Dënuar e Aktit			Afili i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtimi	Nr.	Datë		Emër Arësi Mblenës	Nr. Identifikimi/ NIPT

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dënuar e Aktit			Afili i Kufizimit	Përfitues/Kërkes	
			Emërtimi	Nr.	Datë		Emër Arësi Mblenës	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: \_\_\_\_, Emërtimi i Aktit: \_\_\_\_, Nr. \_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_

Regjistruar: Nr. \_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_

Përshkrimi: Sipas urdherit të ASHKPogradec u ndryshua nr i vol, faqes sipas urdherit NR 247 dt 30.08.2024

DREJTORI  
Zhuljen Manellari

Franci  
Beshiraj

Digitally signed by  
Franci Beshiraj  
Date: 2024.08.30  
02:15:18 +0200

Eugen  
Alinj

Digitally signed by  
Eugen Alinj  
Date: 2024.08.30  
05:15:58 +0200


Zhuljen  
Manellari

Digitally signed by  
Zhuljen Manellari  
Date: 2024.08.31  
12:40:21 +0200



Vlerë elektronike nga Drejtoria  
Venetose Pogradec  
Data: 2024.08.30 14:15:55 +0200  
K44802805FG024003014104E66ASHK

Zëritës / Ky dokument është gjeneruar dhe vlerësuar në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Kufizimeve të Pronësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



# ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
BASHKIA POGRADEC	K44802605R	1/1

Numri i Pasurisë	811		
Kodi Unik	3665014023		
Zona Kadastrale	3665		
Lloji i Pasurisë	KULLOTE		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 243875	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	1		
Adresa e Pasurisë			

DREJTORI  
Zhuljen Manellari

Franci  
Beshiraj

Digitally signed by  
Franci Beshiraj  
Date: 2024.08.30  
07:15:43 +0200

Eugen  
Alinj

Digitally signed by  
Eugen Alinj  
Date: 2024.08.30  
09:30:48 +0200

Digitally signed by  
Zhuljen Manellari  
Date: 2024.08.31  
12:46:05 +0200



Vleruar elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Pogradeç  
Date: 2024.08.30 14:10:26 +0200  
K44802605R2024083014151870L1054



Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe i referuar elektronikisht.  
Në rast të procedurave elektronike nga një shtetë e referuar elektronikisht (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE


ZONA KADASTRALE: 3665

KODI UNIK: 3665014023

NUMRI PASURISË: 811

INDEKSI HARTËS: K-34-114-(

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI

Zhuljen Manellari

Eugen

Alin

Digitally signed by

Eugen Alin

Date: 2024.06.30

08:19:00 +0200

Zhuljen

Manellari

Digitally signed by

Zhuljen Manellari

Date: 2024.06.31

12:46:53 +0200



Valësiq elektronikisht nga Drejtoria  
Versioni 1703a.doc  
Data: 2024.06.30 17:17:37 +0200  
K4463260SR20240600171703264014

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDËRTESA